

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 13.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.66 Akti që i përket:

KËRKUES: SKËNDER ROQI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, PRANË BASHKISË TIRANË, i përfaqësuar nga avokat Kujtim Bara, me autorizim.

ISLAM, YLLI, FATOS, GEZIM, DYL DHE SANIJE KADESHA, të përfaqësuar nga Islam Kadesha.

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1666, datë 16.04.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.2237, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.489, datë 26.03.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.17, datë 09.02.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar se vendimet gjyqësore të të gjitha instancave janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 paragrafi i parë i Kushtetutës dhe konkretisht përmend këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Kundër gjyqtarës që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë, ka paraqitur ankesë për mungesë objektiviteti, por ajo, megjithë porosinë e kryetarit, nuk e ka pranuar ankesën për të vepruar konformë nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile që të vendoste pezullimin e gjykimit gjersa të shqyrtohej çështja e përjashtimit të saj nga Gjykata e Apelit;

- Është nxjerrë jashtë nga seanca gjyqësore e datës 15.04.1997 dhe ky fakt nuk gjen pasqyrim në procesverbalin e seancës. Gjykimi i çështjes ka vazhduar dhe ka përfunduar më datën 16.04.1997 në mungesë të tij me pretekstin se ka pasur dijeni për datën e zhvillimit të gjykimit. Në këtë mënyrë janë shkelur rregullat procedurale si dhe nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit;

- Gjykata, derisa pranon se ka qenë në dijeni të datës së gjykimit, sipas nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, duhej të pushonte gjykimin e çështjes për mosparaqitje dhe jo të rrëzonte padinë;

- Në Gjykatën e Apelit dhe në kolegjin civil të Gjykatës së Lartë, përveç zgjidhjes së padrejtë të bërë nga gjykata, ai ka parashtruar edhe veprimet e parregullta e antiligjore të gjyqtarës së shkallës së parë, por nuk u morën në konsideratë prej tyre. Gjykata e Apelit, sipas nenit 465 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, duhej të përsëriste tërësisht gjykimin dhe jo të mbështetej në aktet e gjykatës së rrethit, të cilat janë të pavlefshme për shkak të shkeljeve të lejuara në këtë gjykatë. Në rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka parashtruar kundërshtimet lidhur me aktin e ekspertimit përse i përket përlllogaritjeve të vlerës së punimeve të kryera në raport me vlerën e banesës së vjetër dhe vlerës së truallit, por Kolegji Seleksionues nuk i vlerësoi këto pretendime.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkuetin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e pronarëve që

kërkoi rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që e la çështjen në çmim të gjykatës dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Skënder Roqi që nga viti 1989 banon si qiramarrës në një banesë shtetërore në të cilën gjatë vitit 1990, me shpenzimet e veta, ka bërë disa shtesa si një korridor, kuzhinë, aneks, etj. Me vendimin nr.314, datë 11.04.1994 të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë, kjo pronë i kthehet trashëgimtarëve të Xhemal Kadeshës, të cilët, në bazë të vendimit të komisionit e kanë kaluar në pronësinë e tyre të gjithë ndërtesën, përfshirë edhe shtesat e bëra nga kërkuesi. Në vendimin e Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, theksohet se raporti i vlerës së shtesave ndaj vlerës së plotë të objektit është 11.7 %, prandaj prona i kthehet ish-pronarit pa kundërshtim, konformë nenit 13 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993. Për këtë shkak kërkuesi, si qiramarrës që ka interes për çështjen i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Tiranë duke kërkuar anulimin e kësaj pjese të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me argumentin se vlera e shpenzimeve për shtesat e bëra në ndërtesë është mbi 60 %. Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr.1666, datë 16.04.1997 ka rrëzuar padinë.

Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë duke parashtruar se ndërtimet i ka kryer me shpenzimet e veta dhe këto janë më të mëdha nga sa ka pranuar gjykata e rrethit. Njëkohësisht në ankimin e tij ai ka bërë prezent edhe pretendimin se është nxjerrë jashtë nga seanca dhe gjykimi i çështjes është zhvilluar në mungesë të tij pa dijeninë e kërkuesit, ndonëse me anë të një ankese drejtuar kryetarit të gjykatës kishte kërkuar që çështja të gjykohej nga një gjyqtar tjetër. Gjykata e Apelit Tiranë, me kërkesën e vet kërkuesit e ka gjykuar çështjen në fakt dhe pas shtatë seancave gjyqësore të, më datën 08.10.1997 ka dhënë vendimin e saj, duke pranuar pjesërisht padinë dhe ndryshuar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave lidhur me vlerën e shpenzimeve nga 11.7 % që kishte vendosur Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në 37 %. Në këto seanca janë administruar dokumentet dhe, përveç shpjegimeve të palëve, ka dhënë sqarime rreth aktit të ekspertimit ekspertja, e cila ka paraqitur edhe një shtojcë të aktit të ekspertimit në përgjigje të pyetjeve të ngritura nga kërkuesi. Në këto rrethana nuk qëndron pretendimi i ngritur nga kërkuesi se Gjykata e Apelit Tiranë është mbështetur në aktet e gjykimit të shkallës së parë, përkundrazi, në zbatim të nenit 465 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, ajo ka përsëritur hetimin gjyqësor, duke gjykuar si gjykatë e shkallës së parë.

Kolegji civil i Gjykatës së Lartë që e ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e kërkuesit në të cilin janë parashtruar pothuajse po ato shkaqe të përmendura në Gjykatën e Apelit, ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se rekursi i paraqitur nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka parashtruar se vendimet gjyqësore mbështeten në akt-ekspertime kontradiktore e të falsifikuara dhe se çmimi i truallit është llogaritur me 1600 lekë m² kur ky çmim duhej llogaritur me 330 lekë m². Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 09.02.2000 ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me nenin 5 të ligjit nr.8431, datë 14.12.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”.

Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar në tërësi shkaqet e parashtruara në kërkesën e kërkuesit Skënder Roqi, arrin në përfundimin se në rastin konkret nuk ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës. Sikurse rezulton nga përmbajtja e rekursit drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të janë parashtruar vetëm argumente që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe në këto rrethana, vendimi i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, duke qenë i bazuar në ligj, nuk ka shkak që të deklarohet antikushtetues. Edhe në vetë kërkesën e kërkuesit nuk përmendet asnjë argument për antikushtetueshmërinë e këtij vendimi. Që të shfuqizohen si antikushtetues të gjithë vendimet e atakuara nga kërkuesi ishte e domosdoshme që shkeljet e pretenduara të ishin ngritur në të gjitha instancat gjyqësore dhe në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet të paraqiten argumente të karakterit antikushtetues për secilin vendim që kërkohet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 08.11.2000

Nr.66 i Regj.Themeltar.

Nr.76 i Vendimit.